




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
Sektori - Tatimi në Pronë

N J O F T I M

Lidhur me shpërndarjen e faturave nga Tatimi në Pronë për vitin 2011

Njoftohen tatimpaguesit se nga data 15.03.2011, ka filluar shpërndarja e faturave për vitin tatimor 2011. Shpërndarjen e faturave tatimore bëhet përmes PTK-së. Nëse eventualisht akoma nuk e keni marrë faturën, kontaktoni në Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, sektorin – Tatimi në Pronë., që gjendet përballë Hotel “Kristal”.

Luten tatimpaguesit që obligimet ti kryejnë në afat ligjor ngase për mos kryerje me kohë pasojnë masat ndëshkuese. Me kryerjen e obligimeve do të përmirësoni kualitetin e jetës tuaj sepse këto mjete do tu kthehen tatimpaguesve në rregullimin e infrastrukturës në komunën e Gjiçanit.

Vlen të theksohet se në vitin paraprak nga inkasimi i mjeteve nga tatimi në pronë kemi grumbulluar 942 mijë e 041 euro. Të gjitha këto mjete janë shpenzuar në rregullimin e rrugëve, kanalizimeve, shkollave, parqeve, dhe të shumë projekteve të tjera të cilat i ka realizuar Komuna e Gjiçanit.

Për çdo vërejtje rreth faturave duhet të ushtroni ankesë Bordit Komunal për shqyrtimin ankesave, deri më 30 prill, përmes Zyrës për Marrëdhënie me Qytetar. Pas skadimit të afatit ligjor ankesat nuk do të shqyrtohen.

Respekt tatimpaguesve.

Drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim
Nuhi NUHIU

www.tatimineprone-rks.org